



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1699 / prot.  
16

Tiranë më 14.12.2021

VENDIM

Nr. 57, datë 14.12.2021

PËR KONTROLLUESIN “ZYRA VENDORE E ARSIMIT  
PARAUNIVERSITAR KAVAJË”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kavajë” (në vijim, “Kontrolluesi”).

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 150, datë 14.10.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe në mbështetje të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 03.06.2021 “Për miratimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2020”, u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi, është përgjegjës për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tij, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel rajonal dhe, ndër të tjera, menaxhon, mbikëqyr, vlerëson dhe

kontrollon institucionet arsimore parauniversitare për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe është përgjegjëse për rekrutimin e mësuesve nëpërmjet portalit Kombëtar “*Mësues për Shqipërinë*”, etj.

2. Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategoritë, “*nxënës*”, “*punonjës*”, “*aplikantë për punë*”, “*prindër*”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

Nga verifikimi i kryer rezulton se institucionet arsimore Shkolla 9-vjeçare “*Rilindja*”, “*Çetë*” dhe “*Herbert*” (nën varësinë e ZVA Kavajë), kanë krijuar në platformën e facebook profile zyrtare në të cilat pasqyrojnë aktivitete të zhvilluara nga këto shkolla, duke i ilustruar ndër të tjera, edhe nëpërmjet fotografive dhe videove të fëmijëve, të marra gjatë aktiviteteve, klasa mësimore, aktivitete sportive, etj., në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit si dhe Udhëzimit nr. 4 të Komisionerit, datë 16.03.2010 për “*Marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 4*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi si përgjegjës për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tij, ka detyrimin të marrë masa në lidhje me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale, në respektim të parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore të përpunimit ku parashikohet se përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit.

3. Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave (prindër dhe/ose kujdestar ligjor të fëmijëve) për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale (fotografi dhe video), për mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses, të drejtën për fshirje dhe/ose korrigjim të të dhënave të tij, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

4. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezulton se nuk është përmbushur detyrimi për “*Njoftim*”, në kundërshtim me parashikimet e nenit 21 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim dhe përditësimi mbi përpunimin e të dhënave personale, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë

subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe në realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

5. Kontrolluesi administron vetëm një adresë zyrtare të postës elektronike (zvakavajë@arsimi.gov.al), nëpërmjet të cilës komunikohet me drejtorët e shkollave, institucionet eprore dhe/ose subjektet e të dhënave. Konstatohet se të gjithë shkollat nën varësi, kanë krijuar adresa emaili nën domainet private yahoo.com, gmail.com, live.com, etj., nëpërmjet të cilave komunikojnë ndër të tjera, edhe të dhënat personale të subjekteve të të dhënave nxënës, mësues, etj.

Kontrolluesi nuk ka marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale, veçanërisht në këtë rast kur përpunimi i të dhënave kryhet nëpërmjet komunikimeve elektronike, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”*, (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se marrja e masave konkrete teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, si dhe pajisjen e punonjësve me adresa emaili zyrtare, pasi komunikimi elektronik i të dhënave nëpërmjet adresave të emailit nën domain-et private, rrezikon cënimin e të dhënave personale të cilat komunikohen midis palëve, konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

6. Kontrolluesi nuk disponon *“Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj. sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një *“Rregulloreje për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen masa konkrete teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

7. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit së Sigurisë së Informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara

nga Udhëzimi nr. 47, për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë që Kontrolluesi ushtron.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47, për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare nëpërmjet shkresës nr. 1699/3 prot., datë 24.11.2021.

Kontrolluesi ka dërguar pranë Zyrës së Komisionerit, Formularin e Njoftimit me nr. 1765 prot., në datë 25.10.2021, pas kryerjes së hetimit administrativ.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit. Kontrolluesi nuk është paraqitur në seancën dëgjimore.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave "a", "b", "d" dhe "dh" të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- c) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin që, shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

## PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 21, 27, 29, 30, 39 pika 1, germat “a”, “b” dhe “dh”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

### V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
- 2- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit;
- 3- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit;
- 4- Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, duke përdorur sfumatura në fotografitë dhe videot e nxënësve (fëmijë-minoren), të publikuara në rrjetet sociale, ose duke marrë pëlqimin me shkrim të prindit të të miturit apo personit i cili gëzon përgjegjësinë prindërore, për publikimin e të dhënave të tyre, sipas parashikimit të pikës 24 të nenit 3 të Ligjit;
- 5- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa konkrete, për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave;
- 6- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 21 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
- 7- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të hartojë “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
- 8- Kontrolluesi, të marrë masa për garantimin e sigurisë së informacionit të përpunuar nga punonjësit, duke shmangur përdorimin e adresave elektronike personale nëpërmjet domaineve private, duke i zëvendësuar me shërbimet e ofruara qeveritare TIK, të standardizuara dhe të sigurta;
- 9- Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;
- 10- Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:

- (i) Menjëherë, detyrimet e treguara në pikën 4 më sipër;
- (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 5 më sipër;
- (iii) Vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 6 më sipër;
- (iv) brenda 45 (dyzetepesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 7, 8 dhe 9 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti.

11- Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;

12- Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit;

13- Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 14.12.2021.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

